



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr. 888/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesuese, Ymer Hoxha dhe Afijete Sada-Gllogjani anëtar, me pjesëmarrjen e Zyrtarit të Lart Ligjorë Kudret Hasani, duke vendosur përkritazi me apelet e parashtruar nga Bekir Qusaj, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Dragash nga subjekti politik PDK, me seli në Prishtinë, dega në Dragash, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017, pas shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më datë 12.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHEN si të pabazuar apelet e parashtruara nga Bekir Qusaj, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Dragash nga subjekti politik PDK, me seli në Prishtinë, dega në Dragash, me shenjën ZL.Anr.888/2017 dhe ZL.Anr.889/2017, të datës 10.11.2017, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 pas shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar dy apel ZL.Anr.888/2017 dhe ZL.Anr.889/2017 me datë 10.11.2017 në ora 10:45, nga Bekir Qusaj, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal nga subjekti politik PDK, me seli në Prishtinë, dega në Dragash, me të cilën pretendon se i mungojnë votat e familjareve të tij të cilët kane votuar për të nga Austria dhe Zvicra si dhe dyshon se në Dragash, në shkollën fillore “Ilmi Bahtjari” e njëjta Qendër e Votimit QV nr. 0523A/01R, 0523A/02D, 0510A/01R, 0501x/02d, 0510A/02D, ka mungesa të votave.

Paneli i PZAP-it, në bazë të nenit 13.2 të Rregullave dhe Procedurat e PZAP-it, ka bashkuar apelet dhe i ka trajtuar si një apel të evidentuar me ZL Anr. 888/2017, për shkak të natyrës së njëjtë të rasteve dhe pretendimeve ankimore, dhe për të gjitha apelet vendosi me një vendim, për shkak të efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës.

PZAP-i, pas shqyrtimit të besueshmërisë së apelit dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

PZAP-i, pas shqyrtimit të besueshmërisë dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore si dhe shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apelet janë të pabazuara

Paneli pas vlerësimit të pretendimeve ankimore gjeti se parashtruesi në apele me asnjë provë bindëse nuk ka dëshmuar pretendimet e tij. Prandaj, Paneli apelet i konsideron si të përgjithësuara dhe të pa argumentuara me fakte dhe si të tilla jo bindëse pasi që nuk i plotësojnë kërkesat ligjore të përcaktuara me dispozitën e nenit 117 i Ligjit nr. 03/-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Rrjedhimisht PZAP-i në mungesë të provave dhe dëshmive konkrete dhe bindëse për pretendimet e paraqitura në apele, konstaton se apelet në fjalë janë të pabazuara dhe të pa argumentuara dhe si të tillë i refuzoj.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)

Anr.888/2017 më datën 12.11.2017.

Kryesuesi i Panelit
Zyheri Haziri



PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*